



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

**Nr. 45**

Datë: 11.09. 2017, ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP

Përkthyes: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

---

## RENDI I DITËS

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

### 1. Aktivitetet e ZRPP-së

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për de certifikim të kandidatëve me Aktgjykim të formës së prerë nga Gjykatat e Republikës së Kosovës .

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit të ZRPP-së për de certifikimin e kandidatëve të të cilët kanë bere kërkesë për tërheqje nga listat e certifikuara të Subjekteve Politike.

4. Të ndryshme

## **1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Krvesuese e mbledhjes së KOZ-së**

**Valdete Daka:** Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 45 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me rend dite sikur që e keni para jush. A ka dikush propozim, vërejtje në këtë rend dite?

**Betim Gjoshi:** I përshëndes të gjithë kolegët. Unë po mendoj se, çështja më e ngutshme është se vetëm këto dy nënëpikat e aktiviteteve të zyrës për regjistrim të partive politike, m'u zhvendos, dhe me dal përpara ky miratimi i rekomandimit të ZRPP-ës..., këta që janë tërhequr... Mendoj që ka edhe më pak nevojë me "humb kohë dhe debat" dhe me vazhduar te pika tjetër që e kemi në rend të ditës.

**Valdete Daka:** Atëherë kush është për, për këtë propozim?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë propozim dhe rendin e ditës.

## **2. Aktivitetet e ZRPP-së**

*Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për de certifikim të kandidatëve me Aktgjykim të formës së prerë nga Gjykatat e Republikës së Kosovës*

**Betim Gjoshi:** Më falni nëse mundem... Unë nuk kam qare pa e bërë një vërejtje këtu. Ne, jemi në proces zgjedhore, siç jeni në dijeni edhe ju ne kemi kërkuar që disa takime që më pas aktivitete të sekretariatit si pikë të domosdoshme të rendit të ditës, ta dimë deri ku jemi duke shkuar me përpjekje. Dita ditës, po i afrohem datës 22 tetor edhe ka qenë mirë, mujn edhe me na raportuar edhe gojarisht ndoshta por, mirë është me pas me shkrim me dit d.m.th. vetën po hymë në aktivitet zgjedhore që janë me rëndësi edhe që kanë afate edhe për qytetarët e Kosovës, me shfrytëzuar edhe këtë mundësi që sot e kemi para medieve që me i njoftuar për ato aktivitete duke u bazuar që nuk kemi ndonjfar informim të mjaftueshëm përmes linjës tjetër. Unë kisha kërkuar që nga mbledhja e ardhshme mi pas ato në rend të ditës.

**Adnan Rrustemi:** Në lidhje me këtë, nuk kemi pse me prit mbledhjen tjetër, ne mundemi me nxjerr si konstatim që krye shefi në raport me planin operacional të na përgatis një raport informues të na dërgoj me e-mail secilit prej nesh, duke na njoftuar se deri në cilën pikë kanë mbërri secili aktivitet. Ne i kemi të përcaktuara datat dhe afatet edhe kemi nevojë me pas informacioni për ecurinë e tyre. Shumë shpejt fillon votimi jashtë vendit dhe nuk e di deri ku ka mbërritur përgatitjet për këtë operacion sikur se kanë qenë edhe operacionet e tjera ne proces e sipër, siç është "Sfidomi i Listës Votuese", "Ndërrimi i Qendrave të Votimit", krejt këto janë informata të domosdoshme për ne. Mendoj që s`kemi pse me prit mbledhjen e radhës një kërkesë mundet me dal që krye shefi mundet me na dërguar brenda ditës.

**Valdete Daka:** Faleminderit. Vazhdojmë me zyrën, urdhëro drejtoresh.

**Miradie Mavriqi:** Faleminderit kryetare, të nderuar anëtar të KQZ-së. Zyra ka përgatitur dy rekomandime, rekomandimi i par është për de certifikim të kandidatëve të cilët kanë bërë kërkesë që vullnetarisht të tërhiqen nga procesi zgjedhor ose nga listat e subjekteve politike. Si dhe rekomandimin për certifikimin e atyre kandidatëve, do të thotë kandidatëve të cilët janë dorëzuar si zëvendësim nga subjektet politike. Deri me 8 shtator, gjegjësisht konform nenit 28 ligjit për zgjedhje subjektet politike dhe kandidatët kanë dërguar pesë kërkesa për tërheqjen nga listat e kandidatëve të subjekteve politike për të marrë pjesë në zgjedhjet të cilat do të mbahen më 22 tetor të këtij viti, përputhje d.m.th me legjislacionin në fuqi, zyra rekomandon që këta kandidatë nëse jemi për me i listuar ose me i thirr emrat do të thotë përndryshe i keni në rekomandim emrat e tyre që të de certifikohen sepse janë certifikuar në mbledhjen e parafundit të ju kujtoj të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, nëse është e arsyeshme unë po ju lexoj me emra edhe unë besoj që nuk ka nevojë kaq për de certifikim faleminderit

**Betim Gjoshi:** Se di, ndoshta s'jam krejt i qartë për drejtoreshën e zyrës, po ndoshta që po i decertifikojm edhe e kemi marr propozimin me i vendos d.m.th, a i kemi, a si kemi se..., unë kujtoj, pe zamë p.sh, një subjekti që e njohë, se nja tre i kemi certifikuar në mbledhjen e kaluar, tre i kemi zëvendësuar...Sot, nëse e kemi ndo njërin prej këtyre që e kemi mangut edhe e kom të qarte a kemi me i dhanë një hapësirë për me i zëvendësuar këta që po i de certifikojmë tani, a jo....?

**Miradie Mavriqi:** Në mbledhjen e radhës që janë de certifikuar ata janë certifikuar apo janë zëvendësu më duket, për këta pesë kandidatë të këtyre subjekteve politike janë edhe rekomandimet për certifikim sepse subjektet kanë certifikuar plotësimet për të njëjtat, këta le të decertifikohen.

**Betim Gjoshi:** Nëse mundem të të ndihmoj pak drejtoresh veç mos të ngutemi edhe pot kuptoj që k'i ngarkesë të madhe me mijëra kandidatë, na në mbledhjen e kaluar kemi vendos me i de certifikuar këta kandidatë që i kemi sot mbas rekomandimin e dytë për me i plotësuar për këta që po i de certifikojmë sot a po i sheh partitë as sot nuk kemi këtu zëvendësime d.m.th ta kemi të qartë ndoshta është mirë me shikuar këta d.m.th nëse nuk e kemi me bë zëvendësime është mirë me i u leju mundësin se brenda afatit e kanë dorëzuar kërkesën për de certifikim mos me i lanë partitë edhe i prishin kuotën edhe mos me i lan pa kandidatë që ta mbulojnë një fshat atje a një lagje të qytetit a po diçka tjetër d.m.th është që unë nuk po lyp asgjë ma shumë veç me ju lan mundësin që edhe ditën e parë, në mbledhjen e parë e kemi certifikuar që sot po i certifikojmë a jam i qartë nëse ju duhet kohë na e marrim edhe një pauzë.

**Adnan Rrustemi:** Jo, veç mendoj që e kemi nja 2 vendime brenda kësaj pike e kemi vendimin e parë me i certifikuar, këta kandidatet e parë që janë 3, 5, 7, 9,10 i kemi me i certifikuar edhe pastaj e kemi de certifikimin e këtyre 5 të tjerë, pajtona se këta e vërtet se nga njoftimi që e kemi marr kanë bërë kërkesë pak para mbledhjes kur kemi de certifikuar këta tjerët po për fat të keq pas në qatë mbledhje me i de certifikuar edhe e kemi pas shumë më të lehtë me përmbyll, unë

jam për me i dhënë 24 orë kohë për me përkundu kjo puna e tërheqjes së madhe të zëvendësimeve se nuk ka kuptim, veç ti certifikojmë njëherë ata 10 përpara.

**Miradie Mavriqi:** Po, është një çështje d.m.th një gabim teknik ndoshta, sepse ky rekomandim për decertifikim nuk ka të beje me rekomandimin për certifikim të këtyre, faleminderit.

**Valdete Daka:** Atëherë, tash i kemi për de certifikim 5 kandidatë të cilët me vetë dëshirë janë tërheq nga listat e kandidatëve si në vijim që i keni nuk kam nevojë me i lexuar emrat e tyre, kush është për de certifikimin e këtyre që këta të zëvendësohen brenda 24 orëve të ju jepet mundësia partive, atë here kush është për de certifikimin e këtyre 5 kandidatëve, faleminderit, tash është pjesa tjetër drejtoresh, edhe një çështje nga ky moment subjektet politike prej nga vinë këta 5, kanë mundësi ta zëvendësojnë brenda 24 orëve.

**Miradie Mavriqi:** Ndërsa, rekomandimi i dytë është për certifikimin e kandidatëve të cilët janë certifikuar në mbledhjen e fundit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zyra ka përgatitë d.m.th dokumentacionin e vet kandidateve për zëvendësimin nga 6 subjekte politike, ju i keni të listuara d.m.th kanë të gjitha subjektet politike që kanë dorëzuar kandidatët e tyre, e keni në faqen e parafundit është në tabelë d.m.th për 10 kandidatë nga 6 subjekte politike, janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara me ligj edhe zyra rekomandon që këta kandidatë emrat e tyre d.m.th të certifikohen.

**Valdete Daka:** Kush është për certifikimin e këtyre 10 kandidatëve nga 6 subjekte, vazhdojmë me pjesën tjetër drejtoresh.

**Miradie Mavriqi:** Zyra ka përgatitur në rekomandimin për de certifikim të kandidatëve të cilët kanë aktgjykim të formës së prerë nga gjykatat e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në përgjigjen e këshillit gjyqësor lidhur me verifikimin e kandidatëve të subjekteve politike që kanë aplikuar për certifikim, zyra ju njofton se nga 7360 kandidatë të listave të subjekteve politike janë evidentuar nga gjykatat 86 kandidatë që kanë aktgjykim përfundimtar nga gjykatat themelore të Republikës së Kosovës, kërkesa për verifikim të kandidatëve, subjekteve politike është dërguar me 24 gusht të këtij viti duke u bazuar në nenin 29 pika 1 germa Q të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës i cili nen parasheh se cili kandidatë nuk është i aftë për certifikim gjegjësisht se është i shpallur fajtor për veprë penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në 3 vitet e fundit andaj zyra e rekomandon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të de certifikoj nga listat zgjedhore kandidatët e subjekteve politike si në vijim, ju i keni të listuar të gjithë kandidatët të subjekteve politike i keni të listuara emrat si dhe datat e aktgjykimeve kur kanë hy në fuqi, ju faleminderit.

**Betim Gjoshi:** Unë kom lidhje me këto 2 vendimet që i morëm ma herët drejtoresh ju kisha lutë se kanë drejtë edhe ankesa qytetarët e Kosovës 24 orë për me i publiku vendimet d.m.th individuale për shkak të transparencës, nuk po ja u lexojmë emrat këta të cilët po i de certifikojmë për arsye me i a mbrojtur këtë privatësi apo diçka personave që kanë qenë në garë por vendimi pa qare na duhet me i publiku personat që kanë interes juridik edhe gjithë qytetarët e

tjerë me pas mundësi mu informuar. Ne i murrën vendimet ti de certifikuar 5 dhe mi certifikuar 10, mirë është ti de certifikojmë të gjithë me i publiku sepse ka të drejt ankese sikurse rastet e tjera. E për këtë pjesën tjetër flet kryetarja.

**Valdete Daka:** Pra siç e tha drejtoresha, ne me 24 gusht i kemi dërguar kërkesën Këshillit Gjyqësor dhe përgjigja nga Këshilli Gjyqësor ka ardhur pasi që ne i kemi certifikuar pra subjektet politike dhe kandidatët dhe listat e tyre. Mirëpo në ditën kur i kemi certifikuar me 30 gusht me sa më kujtohet e kemi rezervuar të drejtën që kandidatët të cilët verifikohen se kanë aktgjykime të plot fuqishme në tre vitet e fundit do të de certifikohen. Sot e kemi para vetit me 86 emra të cilët janë verifikuar disa here dhe nga kjo rezulton se këta 86 kandidat kanë aktgjykime të plotë fuqishme të cilat kanë marrë vulën e plotfuqishmërisë në mes 22 gusht 2014 dhe 22 gusht 2017, pra dita e fundit kur kanë aplikuar kur ka qenë afati për aplikim për certifikim të tyre. E tha drejtoresha neni 29 paragrafi 1 pika Q e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme parasheh se cilët kandidat nuk kanë të drejt të kandidohen për deputet apo për kryetar komune dhe në bazë të këti neni sot kemi rekomandimin që KQZ-ja ti de certifikoj këta persona. Unë e hapi diskutimin, nëse ka dikush diçka me diskutuar.

**Adnan Rrustemi:** Faleminderit kryetare, është e vërtet që kjo çështje ka marrë përmasa të diskutimit mjaft të gjerë është mirë që po e diskutojmë ç'është e vërteta. Me gjithë atë, mendoj që duhet me pas një trajtim më të gjerë edhe ligjore edhe kushtetuese mënyra se si trajtohen rastet. E para nuk duhet me i trajtuar gjitha rastet në mënyrën e njëjtë, nuk mendoj që duhet me i trajtuar gjitha rastet në pako sepse as natyra e veprës penale për secilin nuk është e njëjtë, as dënimi nuk është i njëjtë dhe nuk mendoj që kufizimi i një të drejte kushtetuese dhe ligjore duhet të jetë po ashtu i njëjtë. E vërtet është që nën pika e nenit 29 të ligjit në mënyrë të përgjithësuar e përcakton atë që e thatë por në anën tjetër mendoj që nuk e zbërthen më tej ashtu siç do të duhej ta zbërthente dhe ashtu siç janë edhe praktikrat e vendeve të ndryshme dhe dokumentet e qeverisjes së mirë të procesit zgjedhor.

Në anën tjetër si KQZ, tha z. Rrustemi, nuk mendoj që është vetëm ligji për zgjedhje respektivisht kjo fjali obligim ne duhet mi pas parasysh edhe aktet e tjera janë të nevojshëm për bazë edhe në zbatim edhe dokumentet e tjera juridike duke filluar nga kushtetuta neni 45 që ne gjithë e dimë kur flet për drejtën aktive dhe pasive të qytetarit, drejtën civile të themelore politike, të drejtën për të zgjedh dhe për të zgjedhur e thotë në mënyrë të qartë që çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën 18 vjet qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve gëzon të drejtën të zgjedh dhe të zgjidhet me përjashtim thotë kur kjo e drejt qoftë ajo për të votuar ose për tu zgjedhur i kufizohet me vendim gjyqësor. Në anën tjetër unë kam pasur këto dit mundësi me hulumtuar me rregullimin që i bëjnë vendet e tjera, më falni për kohën por më duhet me ju referuar për ta qartësuar komplet vendimmarrjen sepse mendoj që ne duhet me qenë të kujdesshëm që vendimi mos me pas arbitrash, se po bëhet fjalë për një përkufizim të një drejte themelore. Unë jam plotësisht i bindur që në mesin e kësaj liste ka shumë që e meritojnë mu de certifikuar, që e meritojnë mos me qenë pjesë të listave. Por në anën tjetër po ashtu jam i bindur që ka të tjerë që për vepra shumë të thjeshtë të vogla që vijnë edhe nga pakujdesia po e marrë

shembull me dënime shumë të ulëta me gjobë 150 euro 200 p.sh aksidente e thjeshta të vogla pa lëndime në komunikacion që ne t`ja heqim një të drejt kushtetuese në këtë rast duke e barazuar me dikë që e ka keqpërdorur detyrën zyrtare ose që është dënuar për korrupsion ose për një veprë të rënd etj. Por jam kundër që mi trajtuar siç thash në fillim në një pako, mendimi im është që ne do të duhet ti kishim një për një në bazë të një kufiri që vendosim duke ju referuar disa ligjeve të tjera në këtë rast duke ju referuar kodit penal se deri në çfarë dënim kanë atyre të veprës ne duhet të ja u heqim të drejtën për tu kandiduar. Meqenëse ligji për zgjedhje nuk e përcakton atë e as natyrën e veprës dhe as masën e dënimit, por kushtetuta thotë që kufizohet me vendim gjyqësor, në anën tjetër sipas kodit penal neni 62 parashihet si dënim plotësues heqja e të drejtës ekzekutivisht për tu zgjedhur d.m.th për tu kandiduar dhe që thotë kështu, gjykata ja heq kryt si të veprës penale të drejtën për tu zgjedhur prej 1 deri në 4 vjet, nëse ai person me qëllim që të zgjidhet, kryen ndonjë veprë penale kundër drejtave të votimit ose veprë tjetër penale thotë për të cilën është paraparë dënimi me së paku 2 vjet burgim, siç e thash d.m.th kodi penal në nenin 63 gjykatat kompetente kanë pas mundësin që kandidatët në këtë rast të i caktojnë edhe dënimin plotësues duke ja hekur të drejtën për tu kandiduar në bazë të natyrës së krimit ose edhe në bazë të natyrës së dënimit.

Unë, tha z. Rrustemi, po i referohem shkurtimisht disa prej vendeve që kom mbërri këto 2 ditë me hulumtua rregullimin kushtetues edhe ligjor po e marr shembull në Gjermani kodi penal imponon heqjen e të drejtës për të kandiduar në zgjedhjet publike në rast të dënimit për një krim me burgim për një periudhë jo më pak se 1 vit ky dënim shtesë zgjat 5 vjet dhe fillon kur të ketë përfunduar vuajtja e dënimit me burg, në Mbretërinë e Bashkuar personat që e vuajnë dënimin me burgim për më shumë se 1 vit nuk mund të zgjidhen për kohën e kryerjes së dënimit, në Australi po ashtu, një person i dënuar dhe duke vuajtur dënimin për një veprë të dënueshme me burgim për një vit ose më gjatë s`kualifikohet nga kandidimi për zgjedhje, në Maqedoni po e marr shembull ligji për zgjedhjet e përgjithshme e përcakton nenin 7 se një kandidati i hiqet e drejta për të kandiduar ose që gjendet ne vuajtje të dënimit për veprën e kryer penale dhe se me aktvendim të plot fuqishëm gjyqësor nuk i është kumtuar dënimi me burg për së paku 6 muajsh, në Shqipëri me ligjin për zgjedhje, kodin zgjedhor respektivisht që i referohet nenit për këtë aspekt kushtetutës thotë që çdo shtetas që ka mbushur 18 vjet që voton në ditën e zgjedhjes ka të drejtën të zgjidh dhe të zgjidhet, përjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të vetë formës së prerë si të pa aftë mendërisht dhe të dënuarit që janë duke e vuajtur dënimin me heqje të lirisë kanë vetëm drejtën për të zgjedhur, në Turqi po e marr shembull neni 76 i kushtetues e përcakton që një kandidat i cili është dënuar me 1 apo më shumë vjet burgim nuk mund të zgjidhet në asnjë institucion përfaqësues përveç tjerash aty vendoset edhe natyra e veprave të lidhura me kohëzgjatjen e dënimit gjithashtu aty theksohet se veprat penale të shkaktuara nga pakujdesia nuk krijon pasoja juridike të mohimit të se drejtës për tu zgjedhur në institucione duke qenë se në rregullimin ligjor, ligji për zgjedhje nuk e përcakton veç se e përshkruan në mënyre të përgjegjësuar veprën penale në 3 vitet e fundit, unë mendoj që duhet të i referohemi kodit penal si ligj d.m.th ekzekutiv për çështje penale dhe të marrim për bazë nenin 63 kur flet se gjykata ia hekë kryet si të veprës penale të drejtën për tu zgjedhur për 1

deri në 4 vjet nëse personi me qëllim për të zgjidhur ta kryen një vepër penale kundër të drejtave të votimit ose vepra tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi më së paku 2 vjet burgim, natyrisht që është edhe neni 100 dhe 101 i kodit penal kur flet për lindjen e pasojave juridike të dënimit dhe kallëzon se në cilat raste pasojat juridike ose në cilat dënime nuk vlen, unë e di që jemi në një situatë specifike do të thosha por ne duhet me qenë të kujdesshëm që veprimi jonë, vendimi jonë të mos jetë arbitrar d.m.th po të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtën civile dhe politike por në anën tjetër edhe të përmbushim një obligim në përputhje me kodin penal d.m.th personalisht në mënyrën qysh na u kanë prezantuar një listë e përgjegjësuar me emra pa u përshkruar, pa na u dhanë natyra e veprës, natyra e dënimit, masa e dënimit unë jam kundër të trajtimit të tyre në pako si të tillë personalisht nuk jam sigurt që duke e zgjidh një çështje ose duke plotësuar një aspekt ligjor po i bëjmë disa të ndara në anën tjetër d.m.th unë në fund e kam një pyetje për drejtoreshën, që me na dhanë përgjegjëse që ZRPP-ja këto raste i ka trajtuar edhe në raport me nenin 45 të kushtetutës edhe në raport me nenin 63 të kodit penal edhe në raport me nenin 100, 101 të kodit penal dhe jo vetëm me paragrafin ose fjalinë e do të thosha të ligjit për zgjedhje.

Në fund, theksoi Rrustemi, po e citoj edhe një nen të kushtetues Republikës së Kosovës, që është neni 55 pika 4 ku flet për rastin e kufizimit të një të drejte themelore të njeriut, thotë me rastin e kufizimit të drejtave të njeriut dhe interpretimit të kufizimit të gjitha institucionet e pushtetit publik dhe sidomos gjykatat e kanë për detyrë ti kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet si dhe të shqyrtojnë mundësin e realizimit të ati qëllimi me kufizim më të vogël d.m.th asnjë nga këto që i citova as neni 45, as 55.4 i kushtetutës as neni 63 i kodit penal, me sa po e shoh nuk është marr për bazë, po pres përgjigjen me i trajtuar këto raste me përputhje me këto tri nenet e tjera të kushtetutës, kodit penal për me u garantuar na që po marrim një vendim të drejt për qytetarët.

**Miradie Mavriqi:** Ne, kur i kemi dërguar kërkesë këshillit gjyqësor, i kemi dërguar shkresë listën e kandidatëve kur e kemi dorëzuar ju kemi thanë, a ka kandidat të cilët janë dënuar në tri vitet e fundit? Kjo është do të thotë, vetëm kaq ajo është shkresa sqaruese ka qenë. Mirëpo ne jemi marrë e kemi marr bazë ligjin për zgjedhje neni 29 pika 1 nën Q, edhe të gjitha akt gjykimet i kemi këtu me veti tash mi përshkruar secilin akt gjykimet një nga një nuk e di se e kemi pasur për obligim mirëpo ndoshta nëse mendoni se është ajo me i marr përshkrimet e dënimeve me i marr me i krahasua me nenin 63 , jo absolut vetëm me nenin 29 dhe me nenin 45 të kushtetutës.

**Valdete Daka:** Unë, e konsideroj që kodi penal e ka krye punën këtu sepse këta persona janë dënuar në bazë të kodit penal i cili është në fuqi Kosovë edhe neve ky kod penal nuk na obligon por na obligon ligji mbi zgjedhjet e përgjithshme dhe ligji mbi zgjedhjet lokale të cilët janë lekspecial në krahasim me ligjet e tjera për neve, ne nuk mundemi mu lëshuar në ata se a ka vepra të lehta a ka dënime të rënda apo të lehta, vepra penale është vepër penale dhe këta persona janë te dënuar për çfarëdo kofshin vepër ne tash nuk mundemi me dal publikisht apo me

denoncua ata emrat e tyre edhe veprat për të cilat ata janë dënuar sepse nuk është obligim i joni, obligim i joni është vetëm mos mi lejuar me kandidua asgjë tjetër e jo edhe mu marr me ata se çfarë veprë kanë krye edhe a është ajo vepër e rëndë a e lehte apo janë dënuar me gjobë apo me burg apo me çka d.m.th nuk është ajo detyrë e jona as obligim i joni që ata njerëz tash publikisht me i shpall emrat e tyre apo me i tregu publikisht secili për çka është dënuar dhe sa është dënuar..

Secili, tha znj. Daka, e din për çka është dënuar dhe sa është dënuar, na skena nevojë ata me publiku e as me e shfaq në opinion sepse tek e fundit edhe i shkelim edhe ndonjë drejtë tjetër të tyre mirëpo na si KQZ e kemi pas këtë obligim dhe e kina konsiderua që me shkresën të cilën ja kemi dërguar këshillit gjyqësor e kina krye një obligim tonin ligjor e ai është që mos të lejojmë të kandidohen kandidatë ashtu siç e parasheh neni 29 i ligjit për zgjedhjet e përgjithshme e i cili zbatohet edhe për zgjedhjet lokale, çështjet tjera akademike mundem me thënë edhe se si kjo rregullohet në shtetet tjera ndoshta edhe unë pajtohem që ka vepra penale për të cilët ndoshta nuk është në rregull që dikujt ti mohohet e drejta që të kandidoj, po për deri sa një ligj është në fuqi na nuk mundemi me e zbatuar ligjin në mënyre selektive as nuk jemi na ata që e marrim atë të drejtë që dikon me lejuar me kandiduar e dikon mos me lejuar me kandiduar për deri sa kushtet janë të barabarta për të gjithë, e ne duhet me u kujdes që këto kushte të jenë të barabarta për të gjithë.

**Adnan Rrustemi:** Unë jam dakord, e vërteta është se ne nuk e kemi pasur secilin rast këtu as aktgjykimit. Jam dakord që këtu ka raste plot që e meritojnë mu de certifikuar edhe unë jam pro de certifikimit por në anën tjetër siç e thash në fillim jam kundër de certifikimit të personave të cilët kufirin e veprës së tyre penale dhe veprës kundërvajtje do të thosha është shumë i hollë. Njerëzit që janë dënuar me 150 euro gjobë për shkak të një aksidenti të lehtë në komunikacion me ja heq një të drejtë kushtetuese i cilit do subjekt që të jetë se nuk i kam fare këto me subjektin e caktuar i cilit do subjekt politik. Ideja është që ne mos ta trajtojmë me arbitraritet këtë përkufizim të nenit, ti referohemi nenit në këtë rast të kodit penal se vetë neni i ligjit po flet për vepër penale të shkojmë te kodi penal që e zbërthen natyrën e veprës penale, dënimit, masave etj. Edhe ta vendosem një kufi se kush nuk duhet për me u kandiduar, natyrisht ata që janë dënuar mbi 2 vjet me burgim pse jo padyshim edhe me marr për bazën natyrën e veprës penale d.m.th që është keq përdorim i detyrës zyrtare korrupsioni , krimeve të rënda, njerëzve me burgim efektiv etj. Por jo rastet që, si me thanë pa vullnet nga pakujdesia po i quajmë secilit mundet me ndodh një aksident nesër, sot, pasnesër, dhe me iu kufizuar një e drejtë e tillë kushtetuese kjo për mu është gabim do të thosha mendoj po bimë ndesh me nenin e kushtetutës, në anën tjetër po ti kishim d.m.th dhe unë i propozoj që të na sjell një për një rastet drejtoresha Zyra me natyrën e veprës, me masën e dënimit dhe të vendosim po paraprakisht ta përcaktojmë si me thanë një kufi edhe të dënimit edhe të natyrës së veprës dhe pastaj ti trajtojmë secilin po jo në pako.

**Valdete Daka:** Unë më duket e thash mendimin tim po secili ka të drejtë ta thotë mendimin e tij por unë nuk konsideroj se na mundemi me marrë atë përgjegjësi edhe me i nda dënimet e lehta edhe të rënda sepse as veprat të rënda e të lehta, atëherë bëhemi arbitrar.



**Betim Gjoshi:** Të qenurit përgjegjës me në një institucion ose edhe zyrtare nuk i ka gjithmonë vetëm privilegjet e mira i bie që ti ketë në rendë të ditës edhe tema të ndryshme si kjo e sodit, kuptohet që neve si institucion bajagi na kanë ra gjatë këtyre viteve që jemi si institucion i pavarur në tema të ndeshme dhe të rëndësishme d.m.th unë si anëtarë i vjetër i Komisionit Qendror Zgjedhor jam ballafaquar prej problemeve më të ndryshme, në kohën kur as nuk ka funksioni as si institucion. Kjo temë që është d.m.th. e ka ndjeshmërinë e vet është komplekse edhe për këtë unë si anëtarë i Komisionit Qendror Zgjedhor kërkoj që ne të mundohemi ta gjejmë një gjuhë të përbashkët të mbërrijmë deri në konsensus edhe ta tejkalojmë këtë çështje e cila është e rëndësishme. Sa i përket qëndrimit d.m.th. unë mendoj që ligji është i tillë d.m.th. ai që është edhe unë mendoj që ligji në përzgjedhje ne e kemi ligj bazik, e di kundërshtitë që i ka me ligjet për këtë jo rrallë herë kemi kërkuar reformë zgjedhore edhe kemi kërkuar që duhet mu rishiku ky ligj mu përshtat të paktën me ligjin për qeverisje lokale ku i parasheh disa kriteret se kur e humb mandatin me qenë unike po ashtu edhe me ligjin për deputet e me kushtetutën se kur e humb një person të drejtën e të qenit deputet.

Edhe mënyra e kandidimit, tha z. Gjoshi, mendoj që është dashur të jetë analoge me atë. Por, nuk kemi këtë standard, ne kemi një ligj para vetit, e kemi një listë e cila ka qenë më e zgjeruar por, pas filtrimit prej zyrës për të cilën edhe mban përgjegjësin kemi mbërrir deri te kjo. Ne e kemi sot para vetës një listë me persona, edhe unë mendoj se vendimet duhet me qenë personale për secilin d.m.th. që të jem i qartë. Unë mendoj që sot e kemi dit të vështir edhe po e marrim një vendim të vështir por, mendoj që kjo është mirë për të ardhmen e Kosovës, është mirë me marr një qëndrim që mu rrit niveli i të marrurit me politik. E di që i marrim në qaf shumë njerëz, nuk d'u me kuptuar si ligj që hyn për ata që kanë pasur dënime simbolike ose kanë pasur dënime me gjoba e çështje tjera, e di që po ju hyn hak por, ligji po ju hyn në hak d.m.th. jo Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Edhe unë e kam par ju si e dini kam ndarë me ju vendime kur një person e ka blerë në shitore një telefon të vjedhur edhe është në këtë listë mu heq, edhe dihet u dënua edhe personi që ja ka shitur telefonin por, nuk është i barabartë me një person tjetër që mund të jetë që ka edhe të tillë për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Unë siç e dini d.m.th. jam munduar me ushtrua njëfarë pavarësie në këtë institucion, unë vi prej një subjekti politik i cili d.m.th. ka marr përgjegjësin që mori e nuk mori vendim Komisioni Qendror Zgjedhor me i tërheq prej listës kandidatët e vet d.m.th., Partia Demokratike do ti përgjigjet, ka qenë e gatshme edhe më herët e din zyra për regjistrim të partive politike e din që kandidatët e vet pa marr parasysh natyrën e veprës ti tërheq edhe ti zëvendësoj kandidat tjerë. E dimë që po hymë në hak, kjo d.m.th. ka qenë obligim i joni që me sqarua që këta persona nuk kanë bërë ndonjë krim, ka pasur prej tyre që d.m.th. si rezultat i pakujdesisë kanë pasur aksident edhe me dëme material pa dëme njerëzor edhe kesi raste të tilla duke qenë viktimë d.m.th. janë dënuar por, i ka dënuar gjykata ne nuk i kemi dënuar d.m.th. kriteri i vetëm ka qenë çfarëdo veprë penale që ka qenë e formës së prerë. Unë ju kisha lut mu ul rreth kësaj me bisedu, në qoftëse ka nevojë edhe një herë mi rishiku rast për rast ulemi i rishikojmë por, mirë është me mbërrir një konsensus d.m.th. mirë është Komisioni Qendror Zgjedhor me dal si ka dal edhe herëve të kaluara një institucion unik, serioz, i përgjegjshëm ndaj publikut në krye të detyrave që ka.

Ne, tha Gjoshi, nuk i kemi zgjedhur këto ligje që i kemi sot, unë e kuptoj d.m.th. vendimet e Komisionit Qendror Zgjedhor nuk kanë qëllim ndaj subjekteve ndaj një individi, me të vërtet mund të ja shkelim ndonjë të drejtë të njeriut diku pa të drejt d.m.th. por, ligji për zgjedhje e ka atë nen d.m.th. neni 29 pika e 4 ku thotë që nëse ndonjë prej këtyre kritereve më vonë e kupton duhet mi decertifiku. Po them është situatë jo e lehtë duke pasur parasysht edhe komplicitetin edhe mënyrën si është KQZ-ja heterogjene e përbërë d.m.th. se njerëzit vijnë prej partive politike për këtë duhet me jap një shembull me tejkalu vetveten. Thash na kanë ra barra më të mëdhaja kemi funksionuar edhe kemi mbajtur zgjedhje kur në Kosovë nuk ka pasur as president as kryetar kuvendi e sa qeveri edhe kemi marr edhe vendime shumë të ndjeshme që kanë pasur të bëjnë edhe me të ardhmen e Kosovës, siç kanë qenë vendimet që kanë pasur të bëjnë me të drejtat e komuniteteve e çështje tjera që i kemi tejkalu, i kemi tejkalu të gjithë së bashku d.m.th. mendoj edhe sot d.m.th. kryetare edhe nëse nuk ka një gatishmëri sot me u marr për mjaftueshmëri të votave, ka qenë mirë me u ul me diskutu me mbajt një mbledhje sot më vonë, nesër d.m.th. me mbërri deri në një vendimmarrje që mendoj shkon komfor ligjit. Kanë të drejt kolegët shqetësimet që po i paraqesin ta kemi të qartë, nuk është çdo sen e pastër d.m.th. se kushtetuta është akti më i lart juridik në vend është edhe kodi penal. E kemi shqetësimin edhe unë vet e kam paraqitur dilemën çka nëse na ankimojnë kandidatët edhe shkojnë deri në fund në Gjykatën Kushtetuese edhe na kthehet një rast ku po mbesim ne si institucion. D.m.th. jemi ardh në një situatë jo të volitshme për, këtë duhet mu ul të gjithë me gjet një zgjidhje d.m.th. zgjidhja sa i përket meje është diskutimi jonë ndërrimi me ta.

Ne, konstatoi Gjoshi, e kemi para vetit sot një listë të rishqyrtuar siç tha drejtoresha të rishikuar ku të paktën i kemi me aktgjykim të formës se prerë. D.m.th., ne është mirë me diskutu a kemi ndonjë dilemë që ndonjëri prej tyre nuk e ka aktgjykim të formës së prerë, nëse kemi dilemë është mirë me ju lënë 24 orë kandidatëve që në KQZ-ë me pru ndonjë dëshmi nëse kanë ndonjë dëshmi që nuk kanë aktgjykim të formës prerë d.m.th. kjo është zgjidhja, ne duhet mu mundu me gjetë ndonjë model që në mes vendimit që e morëm sot edhe të drejtat e njeriut me i respektu të dyjat,. Se, nëse fillojmë m'u konfrontuar sot me njëri tjetrin ne nuk kemi me mbërri te një vendim, neve një kolegë na mungon d.m.th. e kemi mangu edhe në qoftëse janë një e dy e tre kundër ose edhe më shumë ndoshta janë krejt kundër d.m.th. këtë nuk e di, biem deri te një situatë ku nuk mund të marrin një vendim të saktë dhe të drejt d.m.th. mos të ngutemi me marr vendim marrjen se është vendim i ndjeshëm është një standard që po krijohet edhe për të ardhmen. Në qoftëse është ky ligj unë d.m.th. do të jem kritiku më i madhi nëse nuk përdoret për zgjedhje parlamentare se është shumë e padrejtë se një asamblist ose një kandidat për kryetar komune me decertifiku e të njëjtë persona mi lënë në zgjedhje të përgjithshme me kandidu për deputet ose nesër për poste të tjera publike. Unë mendoj që përgjegjësia e posteve publike e zyrtarëve të lart publik duhet me qenë kriteret e njëjta edhe për këtë d.m.th. duhet me dhënë kontributin të gjithë rreth ligjeve dhe rreth përshtatjeve të ligjit. Unë e di që nuk është situatë e lehtë d.m.th. po i lus koleget që të gjithë mi diskutu edhe me mbërri deri te një zgjidhje e mirë që edhe neve na nxjerr mirë si institucion por, që edhe nuk i lëndon personat të cilët janë këtu, se nuk ka njëfar qëllim ndaj asnjërit prej tyre d.m.th. ata vazhdojnë me qenë qytetarë të Kosovës i

kanë komplet të drejtat tjera por, në këto zgjedhje mund të mos jenë kandidat, mundet pas dy jave tri në qoftëse do të ketë zgjedhje me kandidu se ndoshta ju kalon afati tri vjeçar i aktgjykimit. Ky është standardi që e ka vu ligji jo ne. Edhe unë kërkoj unitet nëse nuk ka unitet atëherë është problem.

**Valdete Daka:** Fatëkeqsisht, KQZ-së gati gjithmonë po i bije me implementuar ligjet edhe me vë standarde të cilat instucionet e tjera nuk i kanë, kjo na ka ndodhur edhe në vitin 2013 edhe 2014 kemi marr vendime shumë të rënda të dhimbshme dhe na është dashur shumë shpesh me tejkaluar edhe vetvetën. Po pajtohemi plotësisht me Betimin, sepse edhe ligji na obligon që vendimet me tentuar me i marr me konsensus mes gjithë anëtareve. Qoftëse ka edhe dikush diçka tjetër me thanë, atëherë urdhëroni.

**Sami Hamiti:** Faleminderit kryetare, është e vërtet që jemi në një situatë që duhet me shqyrtua në fokuse gjithanshmërisë, fokusin e ngushtë që duhet ta marrim sot. Edhe gjithqysh do ta marrim një vendim, sepse kështu ka ndodh presioni publik, janë ardhur, ka interferime edhe faktorit ndërkombëtar edhe të shteteve të Kuintit edhe shoh që do të ishte shumë më mirë që një komunikim me ta të jetë më i drejt për drejt me ta. Unë nuk e di që ka pasur drejt për drejt me zyrën këtu komunikime apo marrje të informacioneve çka ka ndodhur dhe qfarë vendime janë marrë nga fillimi, me 24 po themi që është drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të bëhet verifikimi i kandidatëve, i atyre 7.000 kandidatëve të cilët kanë aplikuar për asamblistë në nivel vendi.

Tash, tha z. Hamiti, edhe duhet të themi që ai ligj është prej 2008, edhe ai standard po përdoret për herë të par edhe qëllimi është shumë i mirë, dhe është mirë që dikur ja fillon ai standard edhe përputhet, se ne kemi dy muaj përpara i kemi zgjedhjet qendrore që neni i ligjit 29 i referohet prej 2008 nuk ka ndryshuar edhe nuk e kemi dërguar fare, mund të themi tash është afati i shkurt afati i gjatë, po kryesorja nuk i kemi dërguar as nuk kemi tentuar. Kemi ardhur në një situatë që të kemi një vullnet të mirë dhe të dërgohet, unë po flas inicialesht..., çka me 30 ata nuk janë përgjegj dhe afatet ligjore sipas një plani opercional janë që të bëhet certifikimi i kandidatëve, kandidatët janë certifikuar një për një edhe këta që i kemi sot. Ndërkohë, ka ardhur një listë që është diku me 600 emra, por pa i selektuar totalisht Këshilli Gjyqësorë, na mund të themi gjithçka. Në mbledhjen që e kemi mbajtur me të 6-tin, e kemi pas një listë prej 80-ve, a e kemi pas...?, e cila nuk i ka pas fare Gjykatën e Prishtinës me degët e veta, e kemi pas...? Unë po flas tash që për të gjitha subjektet, 'tu përfshi subjektin të cilën une e përfaqësoj janë largu, dmth në atë ditë kanë ardhur si emra që janë të verifikuar edhe duhet me i decertifiku, si numra jo por, si emra, ata numra qka d.m.th si numra sepse i keni sjell, aq më keq nëse i keni pru numra e nuk ka pasur fakte. Qëndrimi në mbledhjen paraprake të KQZ-ës ka qenë që nuk ju dërgohet lista partive politike pa u shtjerr deri në fund të gjitha. Ju u keni dërguar partive politike më herët edhe ju kanë ardhur kundërshtime të cilat tregojnë që njerëzit nuk i kanë ato vepra ose i kanë të skaduara ose shkallshmëria tjetër e ka anuluar vendimin d.m.th. nuk janë të sakta por, ne na është ardh sepse prej ngutës për mi plotësuar një formë, vetëm me plotësu formën d.m.th. qe ne bëmë po e kryejmë këtë punë është ardhë ai vendim. D.m.th. sot poe shoh nuk janë 12 po janë 9,

interpretimi e jep që ata 3 janë hequr se vulat nuk janë parë mirë d.m.th. ju keni vendosur se nuk po shihet mirë edhe me heq d.m.th atë nivel ka mbërritur besueshmëria që një njeri të hiqet apo mos të hiqet me atë se apo shihet apo nuk po shihet aktgjykimi.

Unë, tha Hamiti, njësoj mendoj që ka nevojë të aplikohet neni ka nevojë por, të jetë i barazvlefshëm për të gjithë. Unë e kam shkresën e gjykatës së Gjakovës, thotë i kemi shqyrtuar vetëm asamblistët që kanë kokuruar në Gjakovë d.m.th. se asnjë qytetarë tjetër apo asamlesit apo kandidatë tjetër i mundshëm i ndonjë komune tjetër nuk paka bërë ndonjë vepër atje, këtë nuk e kanë shqyrtuar fare. Në anën tjetër thotë që ka emra të ndryshëm e në këtë anë nuk po përrputhen, ok i keni përrputh me këtë, në finale thotë megjithatë shkresën po ju dërgojmë se për shkak të volumit të punëve kemi mundur të bëjmë gabime. E tash me ja marr një të drejtë kushtetuese dikujt a? Ai nesër me fitu, prandaj ex komunikimi ka ekzistuar, unë vjet dikush ma ka marr të drejtën, kryetarja apo është interpretim i gazetarëve që nesër do të bëhet de certifikimi i tyre, tash a është prejodikuar që çka pa një debat edhe konsideroj që është qesharake të jepet inponim brenda ditës pa material, fare pa diskutim të votohet edhe tu merret dikujt e drejta. Nuk po them unë që nuk ka në mesin e tyre ka plot por, nëse e trajtojmë duhet të trajtohen barabarsisht të gjithë edhe të kemi listë të sakt edhe të ulemi ta diskutojmë. Nuk jam i bindur që kjo listë, nuk jam i bindur se e keni ndru tri herë katër, a i keni hequr tre anëtar të partisë mos thoni jo, i keni hequr prej listës mbetën atje edhe dy të tjerë i keni hequr nga lista. Atë ditë e keni sjell edhe keni insistuar që me çdo kusht duhet mu votu edhe insistimi ka qenë në atë listë mu votu sepse është e verifikuar. Edhe prej atyre që janë ardh edhe na kan bërë trysni me bo votimin. Prandaj në këtë gjendje në këtë format pa informata për mi plotësu një formë, hipokrizi me mëndu dy muaj përpara nivelit qendror janë bërë që e përfaqësojnë shtetin nuk është bërë nami, është bërë nami tash mi vendos një standard të dobët, se nuk vendos standard se me vendos standard taman është krejt në rregull. Vetëm me punu me kute të ndryshme dkund pse nuk është analizuar mirë ose se është bërë dikush me qenë veq një pjesë që ne e plotësuam formën këta po i heqim në këtë format pa një siguri unë në këtë formë pa e analizuar një nga një në bllok nuk i votoj.

**Valdete Daka:** Faleminderit Sami. Ne i kemi këto aktgjykime, unë ju thash që nuk kish dashur mi shpërnda për publikun por, për anëtarë po i shpërndajmë se krejt aktgjykimet e plotfuqishme me vula të përfaqësueshmërisë, me emra të personave të personave natyrisht nuk kisha dashur që ato emra mu qarkullu edhe për atë arsye edhe nuk i kemi shpërnda sepse nuk kemi nevojë me prek privatësinë e dikujt e as me përfol emrat e personave pa fajin e tyre. Kështu që ne do ti shpërndajmë aktgjykimet dhe në qoftëse nuk ka gatishmëri që sot të merret një vendim, ne mundemi mi marr një vendim, ne mundemi mi marr këto aktgjykime mundeni me i marr të gjithë me i kontrollo edhe nesër ose kur do që të jeni të gatshëm me marr një vendim për decertifikim apo për ju.

**Binak Vishaj:** Kjo çka e thatë tani, më pëlqeu d.m.th. unë pajtona që aktgjykimet mos të shpërndahen këty se përmbajnë të dhëna personale që nuk është mirë me dal në publik se i mbron ligji për këtë nuk guxojmë ti japim vetës të drejt. Është mirë që ne ti marrim të gjitha

anëtarët ti shohim një nga një ta caktojmë një mbledhje të radhës për nesër edhe me ardhë në një kolaudim të saktë që mos ti hym dikujt në hak e të ja shkelim lirit dhe të drejtat civile të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Sa do që kemi vullnet me vendos një standard të till, duhet të sigurohemi që këto aktgjykime përmbajnë afat të plota, sa herë kanë ardhë këtu është dashur verifikim edhe ne. Edhe në mbledhjen e kaluar aktgjykimet që kanë ardhë na ka dal një brenda mbledhjes që ka qenë jashtë periudhës kohore tri vjeqare, ti verifikojmë edhe një herë nuk besoj që është larg deri nesër edhe mundemi me gjet një gjuhë të përbashkët që me mujt me kalu këtë temë.

**Valdete Daka:** Faleminderit Binak. Po urdhëro....?

**Eshref Vishi:** Faleminderit. Unë personalisht pajtona me diskutimet e kolegëve që paraprakisht të diskutohen rreth kësaj teme. Ne, kemi pasur debate dhe diskutime deri në fund rreth kësaj çështje në takimet formale edhe jo formale në të cilat i kemi organizuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Mirëpo, po them shumica, se gati një zëri jemi pajtuar se evidencat e gjykatave apo listat edhe dokumentacionet e ofruara, aktgjykimet kanë qenë të mangëta, kanë qenë jo të plota dhe jo të sakta. Diskutuan kolegët, ne, konsideroj që nuk mund të vendosim mbi të drejtën e dhënë me Kushtetutë të qytetarëve për tu zgjedhur, në këtë aspekt unë mendoj që duhet të jemi shumë të kujdesshëm në marrjen e vendimeve selektive mbi çështjet të cilat po trajtojmë këty. U tha edhe nga kryetarja se listat janë verifikuar jo vetëm një herë, njëhëherë, dy herë, tri herë dhe asnjë herë nuk është nxjerr i njëjti rezultat dhe përfundim dhe këtu vëhet në dyshim saktësia dhe mangësia dokumenteve të ofruara nga gjyqësori. Unë e kam edhe një pyetje që mos ta zgjas shumë dhe të mos përsëriten fjalët të cilat i than edhe kolegët e mi për zyrën e regjistrimit të partive politike. Çka, nëse një qytetar një garues me dokument para zyrës dhe e vërteton saktësisht se nuk është në evidencën e gjyqësorit, si kundër e di mirë kryetarja dhe kolegët e mi që, vet personalisht e kom ofruar një aktgjykim me të cilën një garues në Gjykatën Themelore të x komunës është shpallur i pafajshëm d.m.th. është liruar. Kemi përparimin e të njëjtit vendim, prapë Gjykata e Apelit e rrëzon akuzën e prokurorisë dhe shpallet i pafajshëm dhe është në listën e gjyqësorit. Këto, janë të ndishme dhe janë vendime sensitive.

**Valdete Daka:** Eshref unë ta kisha dhënë përgjigjen. Ne nuk mundemi pafundësisht me verifikuar edhe me verifikuar edhe me verifikuar, ne jemi institucion sikur se është edhe Këshilli Gjyqësor, ata e bartin përgjegjësin për shënimet që i japin jo ne, ne nuk mundemi me marr përgjegjsin për shënimet që na i ka dërguar Këshilli Gjyqësor. Ne i kemi kërkuar me emër me mbiemër edhe këto ditë nëpër media janë duke qarkulluar shifra prej 600 emra, janë të vërteta 600 emra por, nuk janë të gjithë kandidat se mos harron se ka njerëz me emër e mbiemër të njëjtë që ka pasur edhe nga tre katër emra të njëjtë emrin edhe mbiemrin me kandidatin. Mirëpo kur janë verifikuar shënimet tjera personale d.m.th. emri i prindit, datëlindja, ato kanë dal kanë rezultu që ata qytetar të cilët janë të dënuar dhe që e kanë të njëjtin emër e mbiemër nuk janë ai kandidat prandaj edhe lista ka shku duke u zvogëluar vazhdimisht. Dhe në fund kur është caktuar edhe standardi që duhet me qenë tre vitet e fundit edhe ne si datë e kemi marr 22 gushtin 2017 dhe 22 gushtin 2014, dita e plotfuqishmërisë dhe dita kur ka qenë afati i fundit për me kandiduar

për certifikim atëherë kanë ra edhe disa emra. Përndryshe këto emra janë verifikuar edhe kjo listë prej 86 emrave ka ardhë si përfundimtare edhe është verifikuar disa herë. Unë sot do të ja u shpërndaj, në të vërtetë zyrtarët e zyrës do të ja u shpërndajnë aktgjykimet me vula të plotfuqishmërisë dhe këto janë aktgjykimet që i kemi marr nga gjykata, nuk janë aktgjykime të cilat i kemi marr ne prej dikund në rrugë por, janë aktgjykime që në mënyrë zyrtare me vula të plotfuqishmërisë nga gjykatat respektive kanë ardhë dhe ata e mbajnë përgjegjësinë, jo ne... Ne, dikujt duhet mi besuar...

**Eshref Vishi:** Gjykatat nuk po i hjekin një të drejtë për me garu, po i hjek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbi bazë të atyreve vendimeve jo të pa sakta, për arsye të ju hym argumenteve një nga një, unë sjelli edhe një argument tjetër, që ka raste që janë sjell aktgjykime të cilat janë jashtë afatit ligjor të nenit përkatës të kodit të ligjit për zgjedhjet.

**Valdete Daka:** Mirë Eshref ne për ata nuk po marrim vendim, sot që ta përfundoj, nuk po marrim vendim sot i merrni aktgjykimet në qoftëse i keni argumentet shtesë të cilat thonë se qaj person është liruar apo nuk është qaj person, nuk është kandidati shumë në rregull aq ma mirë që se kemi de certifiku prandaj, i merrni aktgjykimet i shiqoni të gjitha 86 aktgjykimet me shënime personale mirëpo ju kisha lut që këto shënime mos të qarkullojnë edhe mos na dalin sepse munden edhe me na padit ata persona për çka i kemi qarkulluar aktgjykimet dhe ndoshta dikush nuk dëshiron me tregu që është i dënuar.

**Eshref Vishi:** Kjo ka përjashtime, përderisa ne duhet të komunikojnë me kandidatët e listave të subjekteve tona politike.

**Adnan Rrustemi:** Aktgjykimet ne i kemi pa që kanë pas edhe pakënaqësi edhe gabime edhe vlersime të gabueshme etj. Po thelbi i diskutimit për këtë çështje nuk është saktësia ose jo e dokumentacionit, mendoj që është gabim që po e diskutojmë në këtë mënyrë, na duhet me shtrua diskutimin, raporti i këtyre vë aktgjykimeve me kufizimin e një të drejte kushtetuese, pra ky është debati që duhet me u bë në KQZ dhe ky duhet me u bë debati me u garantu që na nuk po ja u japim një të drejtë kushtetuese d.m.th me pa që kot nuk na duhet akt gjykimet nëse nuk e vendosim paraprakisht një lloj sfondi të do principeve në çfarë lloj drejtimi po e drejtojmë këtë çështje, unë mendoj që na duhet me u taku edhe me vendos që disa kritere të ekzekutimit do të thosha të këtyre vendimeve si KQZ, që duhet me marr natyrën e veprës penale edhe duhet me marr natyrën e dënimit nuk mendoj që duhet për me zënë një peshk të madhe duhet me hedh rrjetën për me i zënë të gjithë peshqit e vogël mase pari dhe mendoj që ky është gabim, për me largu nga lista dikën që është i dënuar po e zëmë për krim të rëndë për keqpërdorimin të detyrës zyrtare, për korrupsion tash duhet me i largu edhe nja 10 tjera atje që janë të dënuar me 150euro, a 200 diku për shkak të komunikacionit e dikujt për shkak që se ka pagua rrymën etj.

**Valdete Daka:** Adnan, të kisha lutur se ne nuk jemi institucion që mundemi me vendos cili është kriteri. Ka vepra penale të cilat mundesh mi dënuar me gjobë dhe me burg, ajo varet nga

rrethanat nuk kemi me hi ne në atë pse i ka dënuar gjykata. Nuk jemi në pako duke shkuar, po ju shpërndajmë aktgjykimet.

**Betim Gjoshi:** Na jem anëtare të Komisionit Qendror Zgjedhor, na e kem një shërbim profesional i cili e ka për detyrë me i verifikuar edhe me paraqit rekomandimin tu u bazuar në ligjet, unë nuk ja marr barrën kërkujna me i verifikuar të dhënat e tija, nuk jam shkuar as në zyre me ja lyp aktgjykimet e askujt as nuk e di as si person d.m.th, kush dhe kush dhe për kanë është sill aktgjykim sepse nuk është detyrë e imja, puna është se në çoftë se besoj që është sjell në rekomandim mirë ose keq për me votuar për ose kundër e para e punës , në qoftë se mendoj që ka informacion të gabuar ose është e trajtuar gabimisht jam i interesuar me trajtuar në bazë të saja, na mendoj që zyra d.m.th na është mirë me biseduar qysh me gjet rrugë si anëtar të Komisionit Qendror Zgjedhor e cila na e qon ligjin në vend, neve na ka sjell këshilli gjyqësor të mangëta e të plota informacionet na ka sjell na ka lan neve në derë, herët a vonë na ka sjell e dimë që na ka sjell me vonës po na i ka pru, na nuk mundemi me ndenjtë indiferent rreth saj, na një vendim marrje duhet me marr, personat kontaktues të partive janë ata që duhet me i diskutuar me ta, e dyta cili do që të jetë vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor, e që mendojmë na tash, na nuk e këna emocionale për vendim.

Ne, tha Gjoshi, na kanë ardhur vendimet e formës së prerë na e kemi një ligj special, edhe unë mendoj që është i pa drejtë po e këna para vetës është mirë me ia lejuar njerëzve drejtë ankese, është mirë me ia lejuar 24 orë me paraqit faktin ndryshe nëse e kanë, mundet me pas fatin ndryshe zakonisht që na me garantuar që po e marrim vendim të drejtë, thash që është një ndër vendimet ma të rënda d.m.th, këto 10 vite...Opinionin publik, duhet me ditë edhe t'u i marr parasysh krejt këto rrethana që i diskutuan, kolegët kanë shumë të drejtë d.m.th na duhet me u ul edhe me gjet zgjidhje jo mu mundu me iu jep argumente të cilat neve na bëjnë dallime edhe ma të mëdha, unë ju kisha lut si kryetar i Komisioni Qendror Zgjedhor me gjet një mundësi ose me e mbajt një takim sot ma vonë, ose me vazhduar me diskutime jo formale deri të mbërrijmë te një zgjidhje, po me mbërrij një zgjidhje rreth kësaj që të jemi unik, unë jam i interesuar me qenë pjese e një vendim marrje ku të gjithë votojmë dhe jam i bindur për vendimet të cilët po i marrim.

**Valdete Daka:** Faleminderit, unë me qenë se po e shoh që diskutimet në këtë drejtim nuk ka pothuajse të gjithë i thanë mendimet pro e të kundërta, unë me gjithë atë me qenë se këtu u shfaq dyshimet se ka aktgjykime, ata që kanë dyshime le të urdhërojnë le të marrin aktgjykimet, po mendoj jo dyshime po, në qoftë se konsiderojnë që ato shënime janë të pa sakta, le t'i marrin aktgjykimet..., të gjitha janë aty...

Unë për veti, tha znj. Daka, s'kam nevojë me i shikuar se i kom pa, jo për shkak të kërsërisë me i pa se kush janë ata, po për shkak se me i vërtetuar a janë aktgjykimet e plotë fuqishme kurrëgj tjetër, meqenëse kom qellu që jam gjyqtare edhe e di me dalluar aktgjykimin e plotë fuqishëm dhe jo të plotë fuqishëm edhe i kom pa që qito 86 emra i kanë aktgjykimet e plotë fuqishme, në qoftë se dikush ka një argument që ato nuk janë të plotë fuqishme apo që nuk janë qeta persona

të cilët janë kandidat na lirisht urdhëroni, i merrni, i shikoni edhe na mblidhemi përsëri i diskutojmë edhe niherë edhe marrim vendim në qoftë se pajtoheni.

**Sami Hamiti:** Nuk jemi duke dyshuar në problemin e këtyre aktgjykimeve, por jemi duke thënë që lista është gjysmake. Sepse të kanë thënë gjykatat, kanë shkruar që nuk janë të plota dhe jemi duke bërë selektive atëherë po ju lus merrni shkruani këshillit gjyqësor, a i keni të verifikuar emrat në të gjitha gjykatat jo selektivisht me thënë ai i kam trajtuar vetëm këto edhe jemi duke e marrë një vendim selektiv.

**Valdete Daka:** Sa për informatën tuaj, në e-mailin e juaj e keni shkresën e zyrtarit të zyrës për verifikim të këshillit gjyqësor i cili me plot përgjegjësi e thotë se janë vërtetuar 7360 kandidatë nga të gjitha gjykatat, ai e bart përgjegjësin për këtë jo unë se nuk kam shkruar me i vërtetuar as nuk kam pasur nigerenca, pra ai e merr përgjegjësin edhe ata e deklarojnë se i kanë verifikuar 7360 kandidatë. Na, e dimë se ju kemi dërguar emrat e të gjithëve, e atë ju siguroj sepse edhe na i kanë kthyer emrat e kopjuar me zarf ku janë të gjithë emrat pra 7360 emra dhe shkresa e cila na thotë se janë verifikuar të gjithë këta kandidatë. Atëherë ju kisha lanë që na edhe një here ta diskutojmë pak më vonë nëse keni gatishmëri ose nëse doni mundemi edhe nesër mundemi me diskutuar edhe një here dhe ta marrim një vendim të drejt që mos ta kemi. Në qoftë se vjen puna me marr KQZ-ja vendim, a me zbatuar ligjin apo jo atëherë unë nuk di çka me thanë tjetër...!

**Betim Gjoshi:** Unë edhe një here ju kisha lutë që të gjithë me dhanë prej vetvetes për me mbërri deri të një konsensus...Unë, jam në gjendje jo veç sot por edhe nesër edhe 24 orë me biseduar me gjithë kolegët është mirë që ata të cilët kanë dilemë, qysh kam edhe unë të mijat ndoshta, me i hjek secilin d.m.th me shikuar bazën ligjore se ma shumë jam i thirrur për te tona si Komision Qendror Zgjedhor m'i konsiderua të gjitha faktet edhe shkresat që na kanë ardhur prej zyrës dhe me gjet mundësinë qysh në vendim me lan mundësia si ankesë d.m.th, edhe juve si kryetare edhe gjithë kolegët i lus që sot të ulemi edhe nesër të vazhdojmë në qoftë se është nevoja se, dua me mbërri rreth një konsensusi...Me marr një vendim të përgjegjshëm, me tregu që jemi institucioni ma serioz, Ne nuk mundemi..., si rezultat që institucionet e tjera po e zëmë..., Këshilli Gjyqësor, ende nuk e ka një platformë ku mundemi me i pa aktgjykimet në nivel të vendit...Nuk e ka një platformë unike ku paraqiten vendimet...

**Adnan Rrustemi:** Ne, mundemi me diskutuar, mos ta trajtojmë këtu si çështje të konsensusit si me thanë..., që varet nga vullneti politik...Kjo s'ka të bëjë fare me vullnet politik, këtu duhet me u siguruar që ne pe marrim vendimin e duhur, d.m.th, për mua duhet me pas parasysh që mos me u kufizuar veç te kjo dispozitë e ligjit, duhet me iu referuar nenit 45 të kushtetutës, nenit 55.4 të kushtetutës, neni 63 të kodit penal edhe me na sjell zyra kategoritë e ndara të veprës penale, dënimet rast për rast edhe me marr vendim, natyrisht që unë veç po përmblidhi, unë personalisht jam i bindur që kufizimi në këtë rast i kësaj dispozite nuk e ka për qëllim me ndal çdo qytetar që ka çfarëdo, si me thanë precedenti penal, e ka funksionin që me ndal personat të cilët kishin me qenë të pa denjë për një pozitë publike që janë të predispozuar me keqpërdor, me bë dëm etj.



Por, nuk mundet dikush që ka bërë aksident pa vullnetin e tij me u trajtuar njëjtë si dikush që u dënua për keqpërdorim të detyrës.

**Valdete Daka:** Sa për informatën tendë edhe gjyqtaret në qoftë se e kryejnë një vepër penale, rrezikim i komunikacionit që është nga pakujdesia shkarkohen, edhe kjo nuk është e drejtë sepse e ka krye nga pakujdesia.

**Adnan Rrustemi:** Duhet me i pa të gjitha ligjet në këtë aspekt, nuk jam i sigurt kështu po, unë nuk jam kundër edhe ta keni të qartë, unë jam për me i largu njerëzit e inkriminun në raport me sidomos me bërë detyrën publike e që e dëmtojnë institucionin e kemi për plot na, këtu nuk ka as një dyshim, çështja nuk e kam fare si një subjekt politik se thua se kom raste ma së paku fare me profilin e tyre, e kom parimisht këtë punë d.m.th nuk mundemi me i fut me një pako, me një vendim, me një rekomandim krejt personat nga aj që është dënua për korrupsion, deri te aj që vet shkarkua një dëm familjes së tij, po e zë duke e ndez një zjarr në oborr të tij siç e kemi një rast d.m.th nuk jam për me i trajtuar në këtë mënyrë për besë se nuk e këtë ekskluziviteti, por diskutojmë pajtohem që diskutojmë.

**Valdete Daka:** Atëherë i merrni aktgjykimet i shikoni sepse u than që janë të pa sakta. Ata vendosim ne, nuk mundemi me vu kritere ekstra.

**Për KQZ**

**Valdete Daka, kryetare**

-----